

## KOMUNA E MALISHEVËS 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

### Hyrje

Komuna e Malishevës udhëhiqet nga Iniciativa Qytetare për Malishevën (IQM). Kryetari aktual i kësaj komune është Ragip Begaj. Ky është mandati i parë i tij dhe partisë së tij, përderisa Komuna e Malishevës për tri mandate radhazi ka qenë nën udhëheqjen e Partisë Demokratike të Kosovës.

Në zgjedhjet e kaluara komunale, kandidatët për kryetarë kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.<sup>1</sup> Mbi 91.4 % e qytetarëve të Malishevës besojnë që pushteti lokal mund t'i zgjidhë të gjitha apo disa nga probleme me të cilat ballafaqohen ata në komunën e tyre.<sup>2</sup> Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqshmërisë së qytetarëve të Malishevës me pushtetin lokal (Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal dhe Administratën Komunale), del se ka një rënie të theksuar kënaqshmërisë.<sup>3</sup>

Vlerësimet e bëra nga Instituti GAP në fund të vitit 2013 tregojnë se problemet kryesore në atë kohë në këtë komunë kanë qenë mungesa e kanalizimeve dhe prezenca e ujërave të zeza, mungesa e ujit të pijes, zonat endemike nga prezenca e rriqrave të infektuara, mungesa e ndriçimit publik si dhe ekzistimi i deponive ilegale të

---

<sup>1</sup> Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësishë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

<sup>2</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr> (Hapur më 20 qershor 2017)

<sup>3</sup> Ibid. faqe 40

mbeturinave. Disa nga këto probleme janë eliminuar gjatë këtij mandati qeverisës.<sup>4</sup>

## **Problemet aktuale të Komunës së Malishevës**

### **Mungesa e planit zhvillimor komunal**

Komuna e Malishevës akoma nuk ka Plan Zhvillimor Komunal. Edhe pse plani është hartuar nga ekzekutivi dhe miratuar në Kuvendin Komunal, akoma nuk ka marrë pëlqimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sipas bashkëbiseduesve të kësaj komune, miratimi i këtij plani është kërkesë dhe nevojë shumë e rëndësishme pasi që të gjitha ndërtimet që janë bërë deri më tani në komunë janë bërë pa ndonjë planifikim.

### **Mungesa e ndriçimit publik**

Komuna e Malishevës ka mungesë të ndriçimit publik. Ndriçimi publik mungon në fshatrat e mëdha si në Astrazub, Drenovc dhe në Kijevë. Sipas Mozaiukt të UNDP-së, kënaqshmëria e qytetarëve të komunës së Malishevës me ndriçim publik është 43.4%.<sup>5</sup>

### **Mungesa e stadiumit të futbollit në Malishevë**

Komuna e Malishevës akoma nuk e ka stadium funksional të futbollit. Në vitin 2016, Komuna e Malishevës dhe Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për renovimin e stadiumit, mirëpo stadiumi akoma nuk është funksional. Sipas raportit të UNDP-së, kënaqshmëria e qytetarëve më aktivitete sportive në komunën e Malishevës është vetëm 35.5%.<sup>6</sup>

### **Rregullimi i shtratit të lumit "Mirusha"**

Edhe pse në një pjesë të qytetit shtrati i lumit Mirusha është i rregulluar, nevoja për rregullimin e këtij shtrati është që të bëhet nga qendra e qytetit deri në Bajë. Në janar të vitit 2016 si pasojë e reshjeve të mëdha, komuna e Malishevës është përballur me përmytje të mëdha pas vërshimit të lumit. Andaj, vazhdimi i rregullimit të shtratit duhet të ndodhë sa më parë.

### **Mungesa e lidhjes së fshatrave me kanalizimin primar**

---

<sup>4</sup> Instituti GAP, Komuna e Malishevës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor. Burimi: <http://bit.ly/2rRcD7g>

<sup>5</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 81. (Hapur më 20 qershor 2017)

<sup>6</sup> Ibid. faqe 75

Komuna e Malishevës ka mungesë të lidhjes së fshatrave me kanalizimin primar. Sipas raportit të MAPL-së, vetëm 49 % e ekonomive familjare janë të kyçura në sistemin e kanalizimit. Ndërsa vetëm 44% të qytetarëve të Malishevës janë të kënaqur me ujërat e zeza dhe kanalizim.<sup>7</sup>

## Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje

### Kontrollimi i veprimtarisë së gurthyeseve

Në territorin e Komunës së Malishevës ekzistojnë tri kompani gurthyese. Banorët kanë pasur ankesa për fuqinë e eksploziveve që aplikojnë këto kompani dhe njëherazi për sasinë e madhe të pluhurit që shkaktohet nga këta gurthyes. Komuna duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje kësaj çështje me qëllim të evitimit të këtyre dukurive që rrezikojnë jetën e qytetarëve.

### Rregullimi i trotuareve për të shkolla e kompetencës

Komuna e Malishevës ka qenë përfituese e granteve nga Qeveria Norvegjeze për ndërtimin e shkollës së kompetencës. Në këtë shkollë vijojnë mësimet afro 1 mijë nxënës. Rruga për të shkolla kryesisht nuk ka trotuar. Komuna duhet të nis një investim të gjerë me qëllim të krijimit të kushteve për lëvizjen e nxënësve pa qenë të rrezikuar nga lëvizja e automjeteve.

## Trendet buxhetore në Komunën e Malishevës (2017)


Komuna e Malishevës në vitin 2017 ka planifikuar 12.9 milion euro buxhet.<sup>8</sup> Krahasuar me vitin 2013, Komuna e Malishevës ka pasur një rritje prej rreth 2 milionë euro të buxhetit. Ndërsa përveç planifikimeve të rregullta buxhetore Komuna e Malishevës ka bartur nga të hyrat vetanake të vitit të kaluar rreth 177 mijë euro, të hyat e bartua në vitin 2013 ishin më të larta rreth 358 mijë euro. Rritja e buxhetit 2017 krahasuar me kohën e zgjedhjeve të fundit (2013) është bërë në kategorinë e pagave, investimeve kapitale dhe mallra dhe shërbime. Për paga, në 2013 kanë qenë 6.22 milionë euro, përderisa në 2017 ky buxhet është 1.5 milionë euro më i lartë (apo 25%), ndërsa në kategorinë e investimeve kapitale në 2013 Malishevë

<sup>7</sup> MAPL, Raporti i Performancës së Komunave 2015, Burimi: <http://bit.ly/2tsjEE6> (hapur me 20 qershor 2017)

<sup>8</sup> Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rV0sBA>

ka pasur në dispozicion 2.9,4 milionë euro ndërsa në 2017 ka një rritje të buxhetit prej 1.1 milionë euro (apo 38%).


**Figura nr.1:** Buxheti i Komunës së Malishevës 2017



Komuna e Malishevës vazhdimisht ka pasur një dominim të shpenzimeve në paga dhe trendi ka shkuar në rritje, përderisa investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme. Nga buxheti i vitit 2017 Komuna e Malishevës 60 % të buxhetit e ka ndarë për paga ndërsa 31 % për investime kapitale.


Ndërsa krahasuar me vitin 2013, numri i të punësuarve në Komunën e Malishevës është rritur për 7 persona në vitin 2016. Përveç numrit të rregullt të punëtorëve, në komunë janë punësuar edhe 11 persona me kontratë për shërbime të veçanta gjatë vitit 2016.

**Figura nr.2:** Trendët buxhetore në Komunën e Malishevës 2013-2017



Komuna e Malishevës në vitin 2016 ka shënuar progres në të hyra vetanake komunale duke i rritur ato në rreth 152 mijë euro (26%) krahasuar me vitin 2015. Kësisoj gjatë vitit 2016 Malisheva ka pasur të hyra vetanake komunale 739 mijë euro, përdërisa në vitin 2015 shuma e të hyrave ka qenë rreth 586 mijë euro.

**Figura nr.3:** Të hyrat komunale 2013-2016



**Burimi:** Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

## Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna duhet t'i shpeshtojë vizitat e inspektoratit në kompanitë e gurthyeseve me qëllim të sigurimit se këto kompani respektojnë normat dhe standardet mjedisore.
- Komuna e Malishevës duhet të rregullojë trotuarin nga pjesa veri-perëndimore e qytetit deri të shkolla e kompetencës me qëllim të shmangies së lëvizjes së nxënësve rrugës së paraparë për automjete.
- Komuna e Malishevës duhet t'i shtrijë investimet në rrjetin e kanalizimit veçmas në zonat malore.
- Komuna e Malishevës duhet të gjejë forma të investimeve për të shmangur derdhjen e kanalizimeve në lumin e qytetit.
- Komuna e Malishevës duhet të gjejë lokacion në qytet për ndërtimin e një stadiumi.
- Komuna e Malishevës duhet të shoh me prioritet zgjerimin e ndriçimit publik në periferi të qytetit dhe në fshatrat e kësaj ane.

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

**Ky projekt mbështetet nga:**



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*